



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2023:280660

Datë: 27.09.2024

Numri i dokumentit: 06218045

C.nr.1428/2023

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Berkan Hamza, me bashkëpunëtoren profesionale Adelina Çmega, duke vendosur në çështjen juridike kontestimore të paditësve: A.H, K.H dhe B.M, që të tre nga fshati Ratkoc, Komuna e Rahovecit, të cilët sipas autorizimit i përfaqëson avokati S.M nga Prizreni, kundër të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson avokati B.O nga Rahoveci, me bazë juridike kompensimi i ushqimit në punë, vlera e objektit të kontestit 2,070.00 euro, jashtë seancës, më datën 27.09.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET PJESËRISHT SI E BAZUAR kërkesëpadia e paditësve A.H, K.H dhe B.M.

II. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit - Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit A.H nga fshati Ratkoc, Komuna e Rahovecit, në emër të kompensimit për ushqim në punë për periudhën kohore prej datës 19.04.2021 e deri më datën 21.11.2022 për 286 ditë pune të ja paguajë shumën prej 572.00 euro duke e llogaritur nga 2 euro për çdo ditë të prezencës në punë, me kamatë ligjore 8% nga data 11.12.2023 (data e parashtrimit të padisë) e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përmbarimit të detyrueshëm.

III. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit - Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit K.H nga fshati Ratkoc, Komuna e Rahovecit, në emër të kompensimit për ushqim në punë për periudhën kohore prej datës 19.04.2021 e deri më datën 21.11.2022 për 286 ditë pune të ja paguajë shumën prej 572.00 euro duke e llogaritur nga 2 euro për çdo ditë të prezencës në punë, me kamatë ligjore 8% nga data 11.12.2023 (data e parashtrimit të padisë) e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përmbarimit të detyrueshëm.

IV. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit - Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditëses B.M nga fshati Ratkoc, Komuna e Rahovecit, në emër të kompensimit për ushqim në punë për periudhën kohore prej datës 19.04.2021 e deri më datën 21.11.2022 për 286 ditë pune të ja paguajë shumën prej 572.00 euro duke e llogaritur nga 2 euro për çdo ditë të prezencës në punë, me kamatë ligjore 8% nga data 11.12.2023 (data e parashtrimit të padisë) e deri në pagesën

definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përmbarimit të detyrueshëm.

V. HEDHET POSHTË si e palejueshme pjesa tjetër e padisë e paditësit A.H, për periudhën kohore nga data 21.01.2021 deri me datën 18.04.2021 dhe atë për 59 ditë pune, në shumën prej 118.00 euro, në këtë çështje juridike, për shkak të çështjes së gjykuar - res iudicata.

VI. HEDHET POSHTË si e palejueshme pjesa tjetër e padisë e paditësit K.H, për periudhën kohore nga data 21.01.2021 deri me datën 18.04.2021 dhe atë për 59 ditë pune, në shumën prej 118.00 euro, në këtë çështje juridike, për shkak të çështjes së gjykuar - res iudicata.

VII. HEDHET POSHTË si e palejueshme pjesa tjetër e padisë e paditëses B.M, për periudhën kohore nga data 21.01.2021 deri me datën 18.04.2021 dhe atë për 59 ditë pune, në shumën prej 118.00 euro, në këtë çështje juridike, për shkak të çështjes së gjykuar - res iudicata.

VIII. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, që në emër të shpenzimeve të procedurës, paditësve A.H, K.H dhe B.M, t’i paguajë shumën prej 239.00 euro, në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përmbarimit të detyrueshëm.

#### A r s y e t i m

Paditësit A.H, K.H dhe B.M, më datën 11.12.2023, në këtë gjykatë ndaj të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, kanë parashtruar padinë për kompensimin e ushqimit në punë në shumën prej 2,070.00 euro.

Të njëjtit sipas padisë kanë theksuar se janë në marrëdhënie pune si mësimdhënëse në SHMFU “4 Dëshmorët”, në fshatin Sapniq, Komuna e Rahovecit, ku edhe janë duke punuar në këtë institucion. Po ashtu kanë theksuar se për periudhën kohore nga data 22.01.2021 deri më 21.11.2022, paditësve i takon e drejta e kompensimit të ushqimit në punë, gjatë ditëve të pranisë në punë, duke u bazuar në nenin 35 par.7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 21.01.2021, dhe atë shumën prej 2 euro në ditë. Andaj, i kanë propozuar gjykatës që padinë dhe kërkesëpadinë ta aprovojë në tërësi si të bazuar.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, në përgjigjen e saj në padi të datës 12.07.2024, ka theksuar se e kontestojmë padinë në tërësi, padia e paditësve nuk ka bazë të qëndrueshme ligjore, ashtu që e drejta e kompensimit mbi bazën në të cilën është thirrur pala paditëse rezulton se është e pavlefshme. Paditëset kanë ushtruar padi në gjykatë me 11.12.2023, me të cilën kanë kërkuar kompensimin e shpenzimeve të ushqimit, për periudhën kohore nga 22.01.2021 – 21.11.2022, me mbështetjen në Kontratën Kolektive të Arsimit të datës 21.01.2021. Duke shtuar se kërkesëpadinë e konteston në tërësi edhe mbi bazën se më 21.11.2022 MASHT-i, ka shkëputur Kontratën Kolektive të Arsimit të datës 21.01.2021 të lidhur me SBASHK. Duke shtuar se e konteston kërkesëpadinë e paditësit pasi që i mungon legjitimiteti real-pasiv. Po ashtu e njëjta ka theksuar se me aktgjykimin e kësaj gjykate C.nr.167/2021 (2021:050414) të datës

19.09.2023 paditësi A.H është kompensuar në emër të ushqimit për periudhën kohore nga data 21.11.2019 – 18.04.2021. Paditësi K.H me aktgjykimin e kësaj gjykate C.nr.162/2021 (2021:050885) të datës 13.09.2023 është kompensuar në emër të ushqimit për periudhën kohore nga data 21.11.2019 – 18.04.2021. Paditësja B.M me aktgjykimin e kësaj gjykate C.nr.159/2021 (2021:051109) të datës 11.01.2024 është kompensuar në emër të ushqimit për periudhën kohore nga data 21.11.2019 – 18.04.2021. Andaj i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditësve ta refuzoj tërësisht si të pa bazuar ndaj të paditurës Komuna Rahovecit.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Për të vërtetuar gjendjen faktike në mënyrë të plotë dhe të drejtë, gjykata ka bërë administrimin e këtyre provave: kontratën e punës për mësimdhënës me Nr. të protokollit 01/144, e datës 01.09.2021, e lidhur ndërmjet Komunës së Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit dhe paditësit A.H; vërtetimit mbi ditët e prezencës në punë me Nr. prot. 01/, i datës 20.02.2023, i lëshuar nga SHFMU “4 Dëshmorët” në fshatin Ratkoc, Komuna e Rahovecit; kontratën e punës për mësimdhënës me Nr. të protokollit 01/301, e datës 09.09.2015, e lidhur ndërmjet Komunës së Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit dhe paditësit K.H; vërtetimit mbi ditët e prezencës në punë me Nr. prot. 01/13, i datës 20.02.2023, i lëshuar nga SHFMU “4 Dëshmorët” në fshatin Ratkoc, Komuna e Rahovecit; kontratën e punës për mësimdhënës me Nr. të protokollit 01/127, e datës 01.09.2020, e lidhur ndërmjet Komunës së Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit dhe paditëses B.M, dhe vërtetimit mbi ditët e prezencës në punë me Nr. prot. 01/23, i datës 20.02.2023, i lëshuar nga SHFMU “4 Dëshmorët” në fshatin Ratkoc, Komuna e Rahovecit;

Gjykata pasi që bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, mbështetur në dispozitat nga neni 8 dhe 398 të LPK-së, arriti në përfundim se në këtë çështje juridiko-civile duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që:

Nuk ishte kontestues fakti se paditësit kanë të themeluar marrëdhënien e punës tek e paditura. Po ashtu nuk është kontestues as fakti se paditëset për periudhën e kërkuar kohore kanë prezantuar në punë. Në këtë çështje juridike kontestues mbetet fakti se a i takon paditësve pagesa e ushqimit për çdo ditë të prezencës në punë.

Me administrimin e kontratës e punës për mësimdhënës me Nr. të protokollit 01/144, e datës 01.09.2021, e lidhur ndërmjet paditësit A.H dhe të paditurës, gjykata vërtetoi faktin se paditësi ka kontratë pune me të paditurën dhe i njëjti është i sistemuar në vendin dhe me detyrat e punës në SHFMU “4 Dëshmorët” në fshatin Ratkoc, Komuna e Rahovecit.

Me administrimin e vërtetimit mbi ditët e prezencës në punë me Nr. 01 i datës 20.02.2023, gjykata vërtetoi faktin se paditësit A.H, në periudhën kohore prej datës 21.01.2021 e deri më datën 21.11.2022 ka prezantuar në punë në 345 ditët e punës.

Me administrimin e kontratës e punës për mësimdhënës me Nr. të protokollit 01/301, e datës 09.09.2015, e lidhur ndërmjet paditësit K.H dhe të paditurës, gjykata vërtetoi faktin se paditësi ka kontratë pune me të paditurën dhe i njëjti është i sistemuar në vendin dhe me detyrat e punës në SHFMU “4 Dëshmorët” në fshatin Ratkoc, Komuna e Rahovecit.

Me administrimin e vërtetimit mbi ditët e prezencës në punë me Nr. 01/13 i datës 20.02.2023, gjykata vërtetoi faktin se paditësit K.H, në periudhën kohore prej datës 21.01.2021 e deri më datën 21.11.2022 ka prezantuar në punë në 345 ditët e punës.

Me administrimin e kontratës e punës për mësimdhënës me Nr. të protokollit 01/127, e datës 01.09.2020, e lidhur ndërmjet paditëses B.M dhe të paditurës, gjykata vërtetoi faktin se paditësja ka kontratë pune me të paditurën dhe e njëjta është e sistemuar në vendin dhe me detyrat e punës në SHFMU “4 Dëshmorët” në fshatin Ratkoc, Komuna e Rahovecit.

Me administrimin e vërtetimit mbi ditët e prezencës në punë me Nr. 01/23 i datës 20.02.2023, gjykata vërtetoi faktin se paditësja B.M, në periudhën kohore prej datës 21.01.2021 e deri më datën 21.11.2022 ka prezantuar në punë në 345 ditët e punës.

Gjykata ka vendosur ta aprovojë kërkesëpadinë e paditësve për faktin se paditësit në periudhën kohore nga data 19.04.2021 e deri më datën 21.11.2022 në vendin e tyre të punës kanë prezantuar në 286 ditët e punës. Kjo është vërtetuar sipas vërtetimeve të lëshuar nga vetë shkolla ku paditësit kanë qenë duke punuar, ndërsa vërtetësinë e këtyre dokumenteve nuk e ka kontestuar as e paditura. Baza juridike e kërkesëpadisë buron në nenin 90 par.5 të Ligjit të Punës, ku parashihet se *“Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive”*. Ndërsa sipas nenit 35 par.7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 18.04.2017 si dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 22.01.2021 parashihet që *“Të punësuarve, u sigurohet kompensimi për ushqim gjatë punës për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë për një ditë pune është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënie e punës primare në institucionet arsimore”*. Në rast se shumëzohen 286 ditët e prezencës në punë me nga 2 euro, të paditësit A.H do të kemi shumën prej 572.00 euro, në rast se shumëzohen 286 ditët e prezencës në punë me nga 2 euro, të paditësit K.H do të kemi shumën prej 572.00 euro, si dhe rast se shumëzohen 286 ditët e prezencës në punë me nga 2 euro, të paditëses B.M, do të kemi shumën prej 572.00 euro.

Gjykata me rastin e vendosjes, jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në dispozitën e nenit 398 të LPK-së, e cila dispozitë përcakton se *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”*.

Sa i përket pretendimeve të të paditurës lidhur me kompensimin e paditëses A.H, K.H dhe B.M në emër të shpenzimeve të ushqimit në punë, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi A.H me aktgjykimin e kësaj gjykate me numër C.nr.167/2021 (2021:050414), të datës 19.09.2023 është kompensuar për periudhën kohore nga data 21.11.2019 e deri më datën 18.04.2021. Paditësi K.H me aktgjykimin e kësaj gjykate me numër C.nr.162/2021 (2021:050885), të datës 13.09.2023 është kompensuar për periudhën kohore nga data 21.11.2019 e deri më datën 18.04.2021. Paditësja B.M me aktgjykimin e kësaj gjykate me numër C.nr.159/2021 (2021:051109), të datës 11.01.2024 është kompensuar për periudhën kohore nga data 21.11.2019 e deri më datën 18.04.2021. Andaj, sipas aktgjyqimeve të lartcekura vërtetohet fakti se paditësit

A.H, K.Hdhe B.M janë kompensuar edhe për periudhën kohore nga data 22.01.2021 deri me datën 18.04.2021, apo për 59 ditë të prezencës në punë, për të cilën periudhë kohore të njëjtit kërkojnë kompensim edhe me padin e cila është objekt i këtij kontesti.

Gjykata ka vendosur që ta hedhë poshtë si të palejueshme pjesën e kërkesëpadisë të paditësve A.H, K.Hdhe B.M, për periudhën kohore nga data 22.01.2021, e deri me datën 18.04.2021, dhe atë për 59 ditë e prezencës në punë, në shumën prej 118.00 euro, pasi që ka vërtetuar faktin se të njëjtit për këtë periudhë kohore janë kompensuar në emër të shpenzimeve të ushqimit në punë sipas aktgjykimeve të lartcekura. Kjo gjykatë kërkesëpadinë e paditësve A.H, K.Hdhe B.M për periudhën kohore nga data 22.01.2021, e deri me datën 18.04.2021, e ka hedhur si të palejueshme duke u bazuar në nenin 391 pika d) të LPK-së sipas të cilit parashihet që *“Pas shqyrtimit paraprak të padisë gjykata me aktvendim e hedh poshtë padinë si të palejueshme po që se konstaton se: d) çështja është gjë e gjykuar (res iudicata)”*.

Vendimin lidhur me kamatën në lartësi prej 8%, gjykata e mori në kuptim të nenit 382 të LMD-së, duke llogaritur nga dita e paraqitjes së padisë.

Nga të lartcekurat, duke u mbështetur në dispozitat e nenit 90 par.5 të Ligjit të Punës, nenit 2 par.1 pika 1.2 dhe neni 35 par.5 dhe par.7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 18.04.2017 si dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 22.01.2021, nenit 398 të LPK, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimin mbi shpenzimet procedurale gjykata e mori në kuptim të nenit 449 dhe 452 të LPK-së.

#### GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil

C.nr.1428/2023, më datën 27.09.2024

Bashkëpunëtorja profesionale  
Adelina Çmega

Gjyqtari  
Berkan Hamza

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 7 ditëve pas ditës së pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.